



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 146

Tiranë – E martë, 11 gusht 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 72/2015 datë 9.7.2015	Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë..... 10859
Ligj nr. 74/2015 datë 9.7.2015	Për miratimin e marrëveshjeve ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “S2 Albania”, sh.p.k., dhe “Rapiscan systems”, INC “Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve” dhe “Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013”, si dhe të tarifës së shërbimit të skanimit..... 10872



LIGJ
Nr. 72/2015

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
USHTARAKE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ligji nr. 9858, datë 27.12.2007, “Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve të nevojshme, sipas përcaktimeve në Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 9.7.2015

STRATEGJIA USHTARAKE E REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

MESAZH I SHEFIT TË SHTABIT TË
PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9858, datë 27.12.2007, e përmbushi me sukses objektivin strategjik të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

Prej vitit 2009, Shqipëria është anëtare e Aleancës Euroatlantike dhe po bën përpjekje të qenësishme për anëtarësimin në BE. Në këtë

kontekst, Strategjia Ushtarake harmonizon rolin, misionin, përgjegjësitë dhe kapacitetet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me realitetin e ri të sigurisë dhe të mbrojtjes kolektive, harmonizim ky, që bazohet edhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2014.

Strategjia Ushtarake është hartuar duke balancuar të gjithë faktorët e saj. Ajo sjell në emërues të përbashkët pritjet e mjedisit dinamik të sigurisë me objektivat dhe rolin e FARSH-it, në këtë mjedis, si dhe burimet në dispozicion të mbrojtjes, në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Mjedisi i sigurisë, i vlerësuar në këtë strategji, është kompleks dhe me zhvillime, shpesh të paparashikuara. Fryma e vjetër e konfrontimit konvencional midis shteteve duket se po bie, ndërsa fryma e bashkëpunimit dhe e konkurrencës midis tyre është në rritje. Nga ana tjetër, sfida dhe rreziqe të reja, që vijnë nga grupime brenda shteteve, nga aktorë joshitetorë, nga faktorë natyrorë, industrialë dhe njerëzorë, dhe ato që vijnë nga sfidat në zhvillim ndaj sigurisë, pritjet të dominojnë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme. Këto sfida dhe rreziqe kërkojnë politika, koncepte, kapacitete dhe metoda të reja për FARSH-in.

Tabloja nuk do të ishte e plotë po të mos pranojmë edhe realitetin e kufizimeve financiare për mbështetjen e programeve të mbrojtjes, në periudhën afatmesme. Kjo strategji na mëson të jemi më të mençur dhe më të zhdërvjellët në çështjet e mbrojtjes, duke pranuar dhe duke zhvilluar projekte të përbashkëta dypalëshe, shumëpalëshe e rajonale, të formatit *smart defence*.

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë vazhdon të jetë një strategji me karakter mbrojtës, e cila mishëron frymën e bashkëpunimit rajonal për një paqe e siguri të përbashkët.

Krahas mbrojtjes së interesave e vlerave kombëtare, strategjia promovon, gjithashtu, edhe mbrojtjen e interesave e vlerave perëndimore të Aleancës Euroatlantike.

Duke pasqyruar rekomandimet e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, 2013, strategjia përbën një dokument orientues, në duart e drejtuesve civilë dhe ushtarakë të FARSH-it, për zhvillimin e forcës së ardhshme. Ajo shërben si pikë referimi për zhvillimin e dokumenteve të tjera, në nivel operativ, të FARSH-it.



Themeli i forcës së ardhshme, e orientuar nga kjo strategji, është cilësia e kapaciteteve që ajo ofron dhe jo thjesht sasia e numrave të saj. Kjo përjasje e kompensimit të sasisë me cilësinë synon zhvillimin e një force të vogël profesioniste, të mirëtrajnuar, moderne, të motivuar dhe sipas standardeve të Aleancës.

Së fundi, duke falënderuar të gjithë ata që u angazhuan në hartimin e kësaj strategjie, inkurajoj drejtuesit dhe personelin e FARSH-it të përfshihen, me përkushtim dhe me përgjegjësi, për zbatimin e saj.

Gjeneral Major Jeronim Bazo

KREU I

VEÇORITË E STRATEGJISË USHTARAKE

Strategjia Ushtarake është dokumenti themelor që jep parimet dhe konceptet kryesore për zhvillimin, përdorimin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ajo bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe në Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, 2013.

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë orientohet, gjithashtu, nga Traktati i Uashingtonit dhe hartohet në përputhje me Konceptin Strategjik të NATO-s¹.

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë është dokument i hapur për opinionin publik vendës dhe të huaj.

1.1 Veçoritë e Strategjisë Ushtarake

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë merr në konsideratë kushtet e reja, të ndryshuara, të cilat përcaktojnë ndjeshëm karakterin dhe veçoritë e saj.

1.1.1 Strategji në mjedis të përmirësuar të sigurisë rajonale

Strategjia Ushtarake bazohet në një mjedis më të favorshëm të sigurisë rajonale, ku konfrontime të natyrës konvencionale ka pak gjasa të ndodhin në periudhën afatmesme, ndërkohë që mund të shfaqen rreziqe dhe sfida të reja. Harta e re gjeopolitike e rajonit pasqyron ndryshimet pozitive që favorizojnë një mjedis më bashkëpunues dhe me tendencë në përmirësim. Ky mjedis i ri strategjik po kultivon mentalitet të ri në institucionet e sigurisë dhe të mbrojtjes.

1.1.2 Strategji e një vendi anëtar të NATO-s

Strategjia Ushtarake është dokumenti strategjik i

Republikës së Shqipërisë, tashmë si vend anëtar i NATO-s. Siguria dhe mbrojtja e Republikës së Shqipërisë janë pjesë e mbrojtjes kolektive të NATO-s, me përfitimet dhe me detyrimet përkatëse, që rrjedhin prej saj.

1.1.3 Strategji e formuluar pas miratimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK)

Strategjia Ushtarake është hartuar pas miratimit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK), si dhe pas Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM). Ajo reflekton gjetjet dhe rekomandimet kryesore të RSM-së për zhvillimin afatmesëm e afatgjatë të Forcave të Armatosura, të cilat balancojnë kapacitetet e forcës së ardhshme, bazuar në zhvillimet e pritshme të mjedisit të sigurisë, skenarët e mundshëm të përdorimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe burimet në dispozicion të mbrojtjes.

1.1.4 Strategji e bazuar në planifikimin e kapaciteteve²

Në themel të Strategjisë Ushtarake është zhvillimi i kapaciteteve të nevojshme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përmbushje të misionit të tyre kushtetues dhe të detyrimeve, në kuadër të Aleancës.

Zhvillimi i kapaciteteve ushtarake dhe civile bazohet në skenarët më të mundshëm të planëzimit për angazhimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Metodologjia e planifikimit në këtë strategji është Planifikimi i Bazuar mbi Kapacitetet (PBK), i cili mbështet zhvillimin e një force të armatosur, bazuar jo vetëm në numra, por në aftësitë e saj. Kapacitetet e forcës përcaktohen nga cilësia e organizimit, drejtimit, motivimit, trajnimit, pajisjes dhe ndërveprimit të saj me aleatët.

1.1.5 Strategji në kushtet e kufizimeve financiare

Republika e Shqipërisë ndodhet ende nën efektet e krizës ekonomike e financiare botërore dhe evropiane. Në këto rrethana, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të zhvillohen dhe do të operojnë në kushtet e kufizimeve financiare, duke u fokusuar në krijimin e kapaciteteve më të domosdoshme, sipas prioriteteve të mirëpërcaktuara.

Zhvillimi i kapaciteteve të forcës së ardhshme do të arrihet duke synuar një raport të drejtë kosto-efektivitet, një menaxhim më të mirë, si dhe një qasje më të balancuar të shpenzimeve për personelin, operacionet dhe mirëmbajtjen e



modernizimin e sistemeve, të pajisjeve dhe të infrastrukturës.

1.1.6 Strategji e një force të konsoliduar profesioniste

Strategjia Ushtarake është strategji e një force profesioniste, e cila synon të përvijojë zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të saj. Rritja e interesit për profesionin e ushtarakut dhe vendosja e karrierës së tij mbi bazën e performancës individuale dhe kolektive do të jenë në qendër të konsolidimit të forcës profesioniste. Kjo përjasje, e shoqëruar me një motivim më të mirë, do të çojë në rritjen e cilësisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Forca e konsoliduar profesioniste do të jetë një forcë e aftë për të përmbushur me cilësi misionin dhe detyrat, brenda dhe jashtë vendit, më vete apo me aleatët.

1.1.7 Strategji e hartuar me ekspertizë gjithëpërfshirëse

Hartimi i Strategjisë Ushtarake është bazuar në ekspertizën më të mirë, duke përfshirë komandantë, oficerë shtabi, ushtarakë pjesëmarrës në operacione kombëtare e ndërkombëtare, stafe akademike të institucioneve arsimore dhe studimore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, institucionet dhe ministritë e linjës, si dhe konsulencën e aleatëve strategjikë.

KREU II

MJEDISI STRATEGJIK I SIGURISË

2.1 Mjedisi i sigurisë

Kjo pjesë pasqyron analizën e faktorëve që ndikojnë në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë, ashtu sikurse jepen në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe mbi të cilët ndërtohen skenarët e planëzimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2.1.1 Mjedisi global e rajonal i sigurisë

Strategjia Ushtarake vlerëson se mjedisi global i sigurisë është në ndryshim të vazhdueshëm, të shpejtë dhe në mënyrë të paparashikueshme. Burimet e destabilitetit, në këtë nivel, janë të shumta dhe karakterizohen nga përhapja e tyre e shpejtë përtej kufijve të origjinës. Globalizmi ka mundësuar lëvizje të shpejtë dhe pa pengesa të njerëzve, mallrave, shërbimeve, informacionit, teknologjisë e ideve, por edhe të kriminalitetit, armëve, terrorizmit etj. Skena e sigurisë globale do të ndikohet gjithnjë e më tepër prej aktorëve të rinj,

të cilët arrijnë të krijojnë probleme apo rreziqe për sigurinë e përgjithshme, të cilat nuk janë, domosdoshmërisht, në përpjesëtim të drejtë me madhësinë apo me fuqinë konvencionale të tyre. Aktorë joshitetërorë, individë, grupe dhe organizata me profile të ndryshme, që zhvillohen me shpejtësi, duke përdorur metoda asimetrike, që nuk njohin kufij, mund të realizojnë sulme me pasoja të pallogaritshme për sigurinë në nivel global, rajonal apo kombëtar. Sulmet kibernetike dhe përhapja e armëve të dëmtimit në masë përbëjnë një ndër rreziqet serioze ndaj sigurisë globale. Gjatë dekadës së ardhshme parashikohet që rreziqet do të kenë natyrë, kryesisht, asimetrike dhe hibride, të gjeneruar nga aktorë shtetërorë, joshitetërorë apo nga shtete të dështuara. Pamundësia e identifikimit dhe e parashikimit në kohë të këtyre rreziqeve detyron strukturat e sigurisë dhe të mbrojtjes të orientohen në krijimin e kapaciteteve të afta, që, në kohën më të shkurtër të mundshme, të reagojnë me efektivitet dhe sukses ndaj rreziqeve të panjohura.

Në nivel rajonal, Strategjia Ushtarake vlerëson se rajoni i Ballkanit është futur në rrugën e integritimit evropian dhe euroatlantik, me gjithë dinamikën komplekse politike, nacionaliste, tensionet etnike dhe ekzistencën e fenomeneve të tilla si: ekstremizmi, korrupsioni, krimi i organizuar dhe trafiket e paligjshme, të cilat mund të përbëjnë shkaqe të mundshme për destabilitet. Rajoni i Ballkanit mbetet rrugëkalim drejt Evropës, për flukse të emigrantëve të paligjshëm, narkotikëve, armëve, municioneve dhe lëndëve plasëse, duke u vënë në fokus të grupeve terroriste, ekstremiste apo kriminale, brenda apo jashtë rajonit. Shtetet e rajonit janë angazhuar në garantimin e të drejtave të grupeve të ndryshme etnike, por, si rezultat i kushteve të krizës ekonomike, polarizimit politik, rritjes së ndjenjës nacionaliste dhe mungesës së besimit, mund të nxiten tensione dhe dhunë ndëretnike, me pasoja për rajonin. Krimi i organizuar rajonal, korrupsioni dhe interesat oligarkike rrezikojnë qëndrueshmërinë e rajonit. Konsolidimi i këtyre subjekteve me prirje ekstremiste mund të prodhojë rreziqe ndaj paqes, stabilitetit dhe sigurisë në rajon.

2.1.2 Mjedisi i sigurisë brenda vendit

Treguesit politikë, ekonomikë dhe shoqërorë paraqesin një mjedis të brendshëm të sigurisë së vendit me tipare të qëndrueshme dhe me prirje



drejt përmirësimit në nivel kombëtar, vlerësohet se mjedisi i brendshëm i sigurisë së Republikës së Shqipërisë ka njohur përmirësim të dukshëm cilësor. Anëtarësimi në NATO dhe perspektiva e anëtarësimit në BE kanë forcuar demokracinë, kanë rritur stabilitetin e brendshëm dhe e kanë shndërruar vendin në një faktor paqesje dhe stabiliteti në rajon.

Pozita gjeografike e vendos Shqipërinë në hartën e transitit të narkotikëve, me origjinë nga Azia, dhe afër rreziqeve që burojnë nga destabiliteti në Lindjen e Mesme dhe në Afrikën e Veriut. Transferimi i konflikteve politike, veçanërisht i atyre me bazë fetare, trafiket e ndryshme dhe emigracioni i paligjshëm mbeten një sfidë kryesore për sigurinë e vendit.

Shqipëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të mundshëm të ndonjë sulmi terrorist, si rezultat i anëtarësimit në NATO dhe kontributit për paqen dhe sigurinë globale. Ekstremizmi me frymëzim ideologjik, fetar apo nacionalist ushqen veprimtaritë terroriste. Ideologjitë e skajshme mbështeten te padija, varfëria, mungesa e shërbimeve shtetërore dhe lidhjet e shumëfishta rajonale dhe ndërkombëtare. Këto shkaqe krijojnë terren për rekrutimin e individëve vulnerabël, të cilët marrin pjesë në konflikte ndërkombëtare, për shkak të prirjes së tij ekspansioniste, ekstremizmi mund të përbëjë rrezik për kohezionin dhe vlerat e shoqërisë shqiptare dhe të rajonit.

Rreziku konvencional ndaj Shqipërisë, ndonëse i reduktuar shumë, nuk mund të përjashtohet për shkak të detyrimeve, që burojnë nga neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut, Republika e Shqipërisë mund të përfshihet në një konflikt konvencional në rastet kur kërcënohet pavarësia, sovraniteti dhe tërësia territoriale e çdonjërit prej aleatëve të saj. Zhvillimet në kufijtë e Aleancës, keqpërdorimi i pakicave kombëtare për qëllime politike dhe ndryshimi i kufijve, në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar, dëshmojnë për ekzistencën e këtij rreziku.

Reformat e sistemit të sigurisë dhe të mbrojtjes synojnë konsolidimin e mëtejshëm të institucioneve përkatëse. Në këtë kontekst, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të mbështetë reformat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për modernizimin dhe për konsolidimin e mëtejshëm të tyre, për përmbushjen e misionit kushtetues.

2.2 Mundësitë që ofron mjedisi i sigurisë

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë njih dhe vlerëson faktin që, krahas rreziqeve dhe sfidave ndaj sigurisë, rajoni i Ballkanit ofron edhe shumë mundësi që duhet të shfrytëzohen në interes të sigurisë dhe të paqes rajonale.

2.2.1 Orientimi evropian dhe euroatlantik i rajonit

Rajoni i Ballkanit, tashmë, përbëhet nga vende anëtare, vende aspirante apo partnere me NATO-n dhe me BE-në. Të gjitha vendet e rajonit janë orientuar drejt vlerave dhe aspiratave demokratike evropiane dhe euroatlantike, çka rrit bashkëpunimin rajonal, forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, si dhe pjesëmarrjen aktive në ruajtjen e paqes dhe të sigurisë rajonale.

2.2.2 Prania e organizmave të sigurisë në rajon

Prania e OKB-së, NATO-s, BE-së, OSBE-së dhe shumë organizmave të tjerë të sigurisë është një ndër shtyllat kryesore të stabilitetit dhe të bashkëpunimit në rajon. Ky shans duhet të shfrytëzohet nga të gjitha vendet e rajonit për konsultime e marrëveshje racionale në zgjidhjen e çështjeve të sigurisë të ngelura pezull e në interes të procesit të integritetit.

2.2.3 Klimë e përmirësuar dhe besim reciprok

Klima e bashkëpunimit dhe besimi i ndërsjellë në rajon janë më të përmirësuar se më parë. Reformat e sigurisë e të mbrojtjes së vendeve të rajonit nuk kanë synime të hapura të konfrontimit konvencional me njëri-tjetrin, çka pasqyrohet në vendosjen e forcave të armatosura nën mbikëqyrjen e autoriteteve civile, në uljen e sasisë së forcave të armatosura, të zhvillimit të kapaciteteve, kryesisht mbrojtëse, të politikave të hapura për bashkëpunim rajonal, rritjen e kontributeve për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare etj.

2.2.4 Formate të reja të bashkëpunimit rajonal

Formate të reja të bashkëpunimit rajonal kanë filluar dhe pritet të kenë një shtrirje në rritje në fushën politike, ekonomike dhe atë të sigurisë. Pozicioni gjeostrategjik i Ballkanit i ka dhënë shansin të kthehet në një lidhëse të projekteve ekonomike, energjetike, të infrastrukturës, të teknologjisë etj. Perspektiva e përbashkët e rajonit nxjerr në pah nevojën për forcimin e sigurisë, duke rritur frymën e bashkëpunimit dhe duke minimizuar rreziqet dhe kërcënimet në fushën ushtarake janë krijuar iniciativa dhe struktura të



përbashkëta rajonale, ka pjesëmarrje në operacione të përbashkëta dhe në ndihmë të ndërsjellë në raste të emergjencave civile. Ky bashkëpunim pritet të intensifikohet në të ardhmen.

2.3 Kërcënimet, rreziqet dhe sfidat e Mjedisit të Sigurisë

Kërcënimet, rreziqet dhe sfidat ndaj Republikës së Shqipërisë, si vend anëtar i NATO-s, pritet të jenë të natyrës konvencionale dhe jokonvencionale.

2.3.1 Kërcënime dhe rreziqe konvencionale

Partneritetet aktive, të udhëhequra nga NATO-ja, zhvillimi i politikave për mbrojtje të fuqishme, si dhe kontributet e Aleancës për Sigurinë Kolektive kanë minimizuar ndjeshëm rrezikun e një sulmi konvencional. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që rreziku konvencional duhet të shpërfilllet. Aktorë të ndryshëm shtetërorë apo ndërshtetërorë, në rajone të ndryshme të botës, që nuk ndajnë qëndrime të përbashkëta me Aleancën Euroatlantike, po ndjekin dhe mund të vazhdojnë të intensifikojnë projektet e modernizimit të forcave të armatosura të tyre, që mund të jenë me pasoja për stabilitetin ndërkombëtar dhe sigurinë euroatlantike. Në këtë kontekst, Republika e Shqipërisë mbështet përpjekjet dhe merr pjesë aktive në zhvillimin e kapaciteteve kolektive të Aleancës për sigurinë dhe mbrojtjen e popullsisë dhe territoreve të vendeve aleate në kuadrin e nenit 5³. Kjo bëhet akoma më e domosdoshme, kur merren në konsideratë kërcënimet që rrjedhin nga zhvillimet e fundit në krahun lindor të Aleancës, të cilat me shumë gjasa do të zgjasin në kohë. Rajoni i Ballkanit, nga pikëpamja gjeostrategjike, përfaqëson një zonë të spikatur të diversitetit kulturor, fetar, ideologjik, si dhe të konkurrencës për influenca politike-ekonomike. Pjesa më e madhe e vendeve të Ballkanit është fokusuar në procesin e integritetit euroatlantik.

Megjithëse shtetet janë angazhuar në garantimin e të gjitha të drejtave për grupet e ndryshme etnike, si rezultat i krizës ekonomike, polarizimit politik apo rritjes së ndjenjave nacionaliste në rajon, vijon propaganda ekstremiste mbi baza etnike dhe ekzistojnë grupe, organizata dhe subjekte politike me baza etnike ekstremiste. Mungesa e besimit ndërmjet grupeve etnike ndikon në konsolidimin e subjekteve me prirje ekstremiste, duke sjellë kërcënim për paqen, stabilitetin dhe sigurinë në rajon.

2.3.2 Kërcënime, rreziqe dhe sfida jokonvencionale

Terrorizmi përbën kërcënim serioz dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin ndërkombëtar. Grupe ekstremiste fetare dhe kriminale vazhdojnë të përhapen në zonat e ndryshme të globit, shfrytëzojnë rajone të pastabilizuara dhe shtetet e dështuara, duke u shndërruar në kërcënim potencial për sigurinë. Teknologjia moderne e informacionit dhe mundësia e aksesit të terroristëve në armët kimike, biologjike, radiologjike apo bërthamore kanë rritur rrezikshmërinë e sulmeve terroriste. Tensionet rajonale, të ndikuara edhe nga faktorë të tjerë ideologjikë, politikë, fetarë dhe kulturorë, mund të frymëzojnë grupe ekstremiste, të cilat synojnë përhapjen e ideologjive ekstremiste dhe ndërmarrjen e akteve terroriste në zonën euroatlantike, përfshirë Republikën e Shqipërisë. Zhvillimet e fundit në krahun jugor të Aleancës e bëjnë terrorizmin një kërcënim akoma më prezent, si për vendin tonë, ashtu dhe për vendet e Aleancës.

Fatkeqësitë e mundshme natyrore, si: tërmetet, përmbytjet, bllokimet nga dëborat, rrëshqitjet, zjarret masive, si dhe epidemi të ndryshme përbëjnë një tjetër rrezik për sigurinë kombëtare. Ato mund të vijnë edhe nga veprimtaria njerëzore, siç janë aksidentet industriale, tokësore, ajrore, detare apo dhe nga veprimet kriminale, terroriste etj. Ndotja e mjedisit, kufizimi i burimeve, rreziqet për shëndetin, ndryshimet e klimës, mungesat e ujit përbëjnë rrezik për sigurinë.

Përhapja e armëve të dëmtimit në masë përbën kërcënim serioz për sigurinë globale, rajonale dhe kombëtare. Shtetet dhe aktorët joshtetërorë, me qëndrim jomiqësor ndaj Aleancës Euroatlantike, mund të zhvillojnë më tej programet dhe teknologjitë e përhapjes së tyre, duke përbërë një kërcënim të vazhdueshëm për sigurinë, paqen dhe prosperitetin. Shqipëria nuk konsiderohet si objektiv, por si një vendi i mundshëm transit, gjë që paraqet një rrezik për sigurinë.

Sulmet kibernetike janë rrezik potencial për sigurinë globale, rajonale dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Objektiva të këtyre sulmeve mund të jenë administrata, biznesi, ekonomia, sistemi bankar, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sistemet e transportit dhe të furnizimit, sistemi energjetik, infrastruktura kyçe tokësore,



ajrore e detare etj. Sulmet kibernetike mund të shkaktojnë dëme të mëdha dhe pritet të bëhen më të sofistikuar e më të organizuara, me synim cenimin e sigurisë dhe stabilitetit kombëtar dhe rajonal. Forcat e Armatosura i kushtojnë vëmendje të veçantë zbatimit të rregullave të rrepta për sigurinë e informacionit të klasifikuar, në të gjitha sistemet dhe format e shkëmbimit të tij.

Krimi i organizuar dhe trafiket e paligjshme do të vazhdojnë të paraqesin kërcënim për paqen dhe sigurinë në nivel global, rajonal dhe kombëtar. Trafiku i armëve, drogës, qenieve njerëzore, materialeve të rrezikshme, pirateria dhe krimet kibernetike do të karakterizojnë krimin e organizuar ndërkombëtar. Grupe ndërkombëtare të krimit të organizuar mund të bashkëpunojnë me shtete të dështuara, me grupe terroriste, si dhe të përdorin rrjete të sofistikuar, të cilat përbëjnë një sfidë për agjencitë e zbatimit të ligjit.

Destabiliteti politik përbën rrezik për sigurinë dhe mbrojtjen e interesave kombëtare. Përvoja e deritanishme e demokracisë ka provuar se një destabilitet i mundshëm politik rrezikon funksionimin normal të institucioneve, kërcënon paqen sociale dhe sigurinë publike, si dhe cenon rëndë sigurinë kombëtare.

Cenimi i linjave kryesore të komunikimit dhe të furnizimeve, si: siguria e linjave të energjisë, konkurrenca për naftë dhe burime të tjera strategjike përbëjnë kërcënim për sigurinë. Varësia e Shqipërisë nga një numër i kufizuar fuqizuesish rrit nivelin e cënueshmërisë, i cili mund të shkaktohet nga shkaqe teknike apo edhe politike.

KREU III

POLITIKA E MBROJTJES, KONCEPTI STRATEGJIK DHE PARIMET E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ky kre trajton parimet themelore të politikës së mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, konceptin e ri strategjik të mbrojtjes së vendit, rolin e Forcave të Armatosura në mjedisin e pritshëm të sigurisë, si dhe konceptet themelore të zhvillimit dhe të përdorimit të forcës së ardhshme, 2020.

3.1 Parimet e politikës së mbrojtjes

Strategjia Ushtarake bazohet në parimet e politikës së mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, të cilat sanksionohen në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare. Parimet themelore të politikës së

mbrojtjes, të mbështetura nga kjo strategji, janë:

3.1.1 Politikë mbrojtëse dhe paqësore

Politika e mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë nuk paragjykon asnjë shtet si armik, ajo nuk ka asnjë synim të cenojë tërësinë territoriale, sovranitetin apo pavarësinë e shteteve të tjera. Në të gjitha rastet, më vete apo si anëtare e Aleancës, Shqipëria do të përdorë forcën e saj ushtarake si mjet të fundit, kur të jenë shtetur të gjitha mundësitë e tjera dhe vetëm nëpërmjet vendimmarrjes së autoriteteve kushtetuese të vendit. Ajo, në asnjë rrethanë, nuk do ta përdorë forcën ushtarake si qëllim në vetvete për aneksimin e territoreve të vendeve të tjera.

3.1.2 Përdorim sinergjik i elementeve kryesore të fuqisë kombëtare

Siguria dhe mbrojtja e vendit mbështetet në zhvillimin dhe në përdorimin e integruar të elementeve të fuqisë kombëtare, nëpërmjet një qasjeje gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale.

Krahas komponentit politik (diplomatik), ekonomik, informativ e social, Forcat e Armatosura luajnë një rol vendimtar në sistemin e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit.

3.1.3 Politikë mbrojtëse e bazuar në sigurinë dhe në mbrojtjen kolektive

Koncepti i sigurisë dhe i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë është i lidhur ngushtë me konceptin e sigurisë së Aleancës së Atlantikut të Veriut. Planifikimi i sigurisë dhe i mbrojtjes së vendit bëhet në përputhje me atë të sigurisë dhe të mbrojtjes kolektive. Shqipëria synon të jetë pjesë e BE-së, ndaj dhe kjo strategji mban në konsideratë Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe të Mbrojtjes së Bashkimit Evropian⁴.

3.1.4 Politikë mbrojtëse e bazuar në bashkëpunim

Strategjia Ushtarake njeh dhe pranon faktin se, me integrimin në organizmat ndërkombëtarë, Shqipëria është bërë pjesë e realitetit rajonal dhe global në fushën e sigurisë, ku asnjë vend nuk mund të garantojë siguri e paqe të qëndrueshme më vete. Në këtë kontekst, Strategjia Ushtarake mbështet pjesëmarrjen aktive në iniciativat rajonale, në interes të ndërtimit të një klime të bashkëpunimit dhe të mirëbesimit rajonal.

3.2. Koncepti strategjik i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë

Koncepti i sigurisë dhe i mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë është i lidhur në mënyrë integrale me



Traktatin e Uashingtonit dhe Konceptin Strategjik të Aleancës. Si vend anëtar i NATO-s, Shqipëria e konsideron sigurinë dhe mbrojtjen e saj pjesë të sigurisë dhe të mbrojtjes kolektive të Aleancës. Ndërsa misioni kushtetues i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbetet i njëjtë, koncepti strategjik i përmbushjes së tij evoluon ndjeshëm në kushtet e mbrojtjes kolektive të NATO-s, duke pranuar një ndërthurje dinamike të përpjekjeve kombëtare me ato të aleatëve. Për të përmbushur këtë mision, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë planëzojnë, stërviten, pajisen dhe bashkërendojnë veprimtaritë me forcat aleate qysh në kohë paqeje.

3.3 Objektivat e zhvillimit dhe të përdorimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Bazuar në mjedisin e sigurisë, parimet e politikës së mbrojtjes dhe objektivat e Shqipërisë në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, forca e ardhshme do të konsolidohet më tej si një forcë tërësisht profesioniste, me cilësi të larta operacionale për përmbushjen me sukses të misionit, brenda dhe jashtë vendit. Objektivat kryesorë të zhvillimit dhe të përdorimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë:

3.3.1 Forcë e zhdërvjellët shumëmisionëshe

Forcat e Armatosura do të zhvillohen si një forcë profesioniste me elemente të luftimit dhe të mbështetjes së luftimit, mbi bazën e skenarëve të parashikuar. Forca do të jetë e zhdërvjellët për t'u angazhuar në një spektër të gjerë të detyrave luftarake dhe joluftarake, brenda dhe jashtë vendit, në rajone të njohura e të panjohura, si dhe në kushte të vështira të motit dhe të terrenit.

3.3.2 Forcë e bazuar në përparësi

Forcat e Armatosura do të kenë përparësi zhvillimin e kapaciteteve operacionale të luftimit dhe të mbështetjes, veçanërisht ato që lidhen me kapacitetet e mbrojtjes, të deklaruara nga Shqipëria, në kuadër të procesit të planifikimit të mbrojtjes të NATO-s. Duke zhvilluar kapacitetet sipas përparësive, do të synohet njëkohësisht eliminimi i elementeve të trashëguara, që rezultojnë të tepërta, të konsumuara e të panevojshme, si dhe lehtësimi nga strukturat e mbingarkuara ushtarake e civile.

3.3.3 Forcë me sistem të balancuar të shpenzimeve buxhetore

Forcat e Armatosura do të kenë një qasje më të balancuar ndaj tri kategorive të buxhetit: shpenzimeve për personelin, shpenzimeve për

operacionet dhe për mirëmbajtjen, si dhe shpenzimeve për investimet e modernizimin. Buxheti i mbrojtjes do të synojë të mbështesë dhe të motivojë me përparësi një personel përherë e më cilësor, duke krijuar, në të njëjtën kohë, edhe hapësirat e duhura për përmirësimin e nivelit të gatishmërisë dhe modernizimin e vazhdueshëm të forcës.

3.3.4 Forcë e bazuar në një grupim të vetëm kapacitetesh

Forcat e Armatosura do të zhvillojnë kapacitete të integruara për misionet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Synimi do të jetë zhvillimi dhe përdorimi racional i kapaciteteve, sipas konceptit të një grupimi të vetëm për operacione kombëtare dhe ndërkombëtarë, luftarake dhe joluftarake, brenda dhe jashtë vendit, më vete apo të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja apo OKB-ja. Zhvillimi i këtyre kapaciteteve do të bazohet në nivelin e ambicies së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Krijimi i kapaciteteve të tilla do të thotë reduktim në sasi dhe në rritje në cilësinë e kapaciteteve të mbrojtjes.

3.3.5 Forcë e ndërveprueshme sipas standardeve të Aleancës

Një forcë e përgatitur për të kryer operacione më vete apo të përbashkëta, nën drejtimin e NATO-s, BE-së, OKB-së, kërkon një nivel të lartë të ndërveprueshmërisë në planin operacional, doktrinar, taktik, njerëzor, teknik e material. Kjo nënkupton ratifikimin dhe zbatimin e STANAG-ëve të NATO-s në fushën operacionale, materiale dhe administrative, të planëzuar deri në vitin 2020. Pjesë e rëndësishme e ndërveprimit është edhe përfshirja e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në iniciativat për “mbrojtje të mençur”⁵ (*smart defence*) apo të forcave të ndërlidhura të NATO-s, të cilat synojnë që, përmes bashkëpunimit ndërshtetëror, të arrihet efektivitet më i lartë në përdorimin e burimeve të mbrojtjes.

3.3.6 Forcë e motivuar dhe me moral të lartë

Reduktimi i numrit të personelit në Forcat e Armatosura do të kompensohet me rritjen e cilësisë së tij. Rol vendimtar në këtë rritje të cilësisë do të ketë motivimi, drejtimi dhe menaxhimi më cilësor i personelit. Fuqia primare e forcës së ardhshme konsiderohet personeli i motivuar, arsimuar, stërvitur dhe pajisur, në përshtatje me rëndësinë dhe me natyrën komplekse të misionit. Realizimi i kësaj ambicieje sigurohet përmes vendosjes së



standardeve të larta të trajtimit, të cilat do të ruhen në nivele të larta në raport me aktorët e tjerë të tregut kombëtar të punës.

3.3.7 Forcë me pajisje dhe sisteme moderne

Modernizimi i forcës, sidomos i njësive prioritare, do të jetë një përparësi e veçantë në vitet në vijim. Modernizimi i forcës do të vihet në shërbim të pajisjes së individëve, si prioritet i parë, për të vijuar me modernizimin e formacioneve të vogla e më tej atyre më të mëdha. Forca e ardhshme do të jetë një forcë moderne në pajisje e sisteme të ndërveprueshme me ato aleate, sipas standardeve të NATO-s. Standardizimi teknologjik do të synojë ndërveprimin brenda forcave dhe shërbimeve, atë me agjencitë e tjera shtetërore, si dhe me shtetet e tjera aleate.

3.3.8 Forcë me sistem arsimim-stërvitje bashkëkohore

Republika e Shqipërisë synon të zhvillojë një Forcë të Armatosur të bazuar mbi dijen. Kjo do të arrihet nëpërmjet reformimit të mëtejshëm të sistemit të arsimit dhe të stërvitjes së të gjitha kategorive të personelit, në të gjithë spektrin e misioneve, brenda dhe jashtë vendit, dhe sipas skenarëve të parashikuar. Po ashtu, Forcat e Armatosura do të zhvillojnë kërkimet në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, futjes së simulimeve dhe metodave bashkëkohore të përgatitjes luftarake.

3.3.9 Forcë e armatosur e mbështetur në doktrinë

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë doktrinën, e cila shërben si udhërrëfyes për përdorimin e tyre. Doktrina ushtarake hartohet dhe zhvillohet bazuar në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare dhe Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë, si dhe në kapacitetet, organizimin, pajisjen dhe gatishmërinë e tyre. Ajo ofron rrugët se si forcat e bashkuara do të arrijnë objektivat operative e strategjike, në mbështetje të qëllimeve kombëtare dhe në kuadër të Aleancës. Strategjia Ushtarake është mbështetja e doktrinave ushtarake për përdorimin efektiv të forcës në tri nivele: strategjike, operative dhe taktike.

3.3.10 Forcë e pajisur me kapacitete specifike

Si forcë e vogël profesioniste, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të disponojnë një set të kapaciteteve specifike, të cilat nevojiten si për përmbushjen e detyrimeve në planin kombëtar, ashtu dhe në kuadër të

angazhimeve ndërkombëtare. Kapacitete të tilla përfshijnë: xhenio, mbrojtje nga armët e dëmtimit në masë, mjekësi ushtarake, topografi, meteorologji, hidrografi etj.

3.3.11 Përfaqësim dinjitoz në strukturat kolektive të mbrojtjes

Veç pjesëmarrjes në operacione tradicionale ushtarake, Forcat e Armatosura kanë edhe detyrë të mbështesin përfaqësimin ushtarak dhe diplomacinë ushtarake. Kjo detyrë kryhet nga një kategori personeli ushtarak dhe civil, të atashuar pranë strukturave politike, strategjike dhe operacionale të Aleancës, të organizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe vendeve aleate e partnere.

3.3.12 Forcë e përbashkët e orientuar nga misioni

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë organizohen, vendosen, përgatiten, pajisen dhe drejtohen sipas konceptit të forcës së përbashkët, të cilat orientohen nga misioni dhe detyrat e tij, përmes kapaciteteve modulare të luftimit e të mbështetjes. Strukturat kryesore të luftimit e të mbështetjes janë në nivel batalioni, ndërkohë që struktura bazë e luftimit dhe e mbështetjes është në nivel kompanie ose e barasvlershme me të. Njësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë mund të organizohen në trajtën e grupimeve operacionale për detyrë (task force), niveli i të cilave do të varet nga detyra dhe natyra e misionit, në të cilat do të angazhohen.

3.3.13 Një sistem i integruar i komandim-kontrollit

Forcat e Armatosura kanë një strukturë dhe sistem komandim-kontrolli të përbashkët dhe të unifikuar. Sistemi i komandimit dhe i kontrollit i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbështetet në role qartësisht të përcaktuara për gjeneruesit dhe përdoruesit e forcës. Krijimi, mbajtja në gatishmëri dhe stërvitja e forcave është përgjegjësi e strukturave gjeneruese, ndërkohë që komandimi dhe kontrolli në operacione është përgjegjësi e autoriteteve të përdorimit të forcës.

3.3.14 Forcë e dislokueshme dhe e aftë të operojë më vite

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jenë forca me kapacitete që sigurojnë dislokueshmërinë dhe mëvetësinë. Synimi është që 40 për qind e komponentit aktiv tokësor të jetë në gatishmëri për t'u dislokuar, ndërsa 10 për



qind e dislokueshme⁶ (modulet e grup-batalionit të motorizuar) dhe e mbështetur nga ana logjistike për një rotacion 6 muaj deri në 1 vit në angazhimet e Aleancës.

3.3.15 Forcë me sistem funksional të gatishmërisë luftarake

Sistemi i gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë bazohet në forca të gatishmërisë së menjëhershme dhe forca të gatishmërisë së përshkallëzuar. Bazuar në llojin e operacioneve ku marrin pjesë, Forcat e Armatosura mbajnë në regjime të përshkallëzuara gatishmërie kapacitetet e tyre operacionale. Në përcaktimin e sistemit të gatishmërisë luftarake mbahet parasysh koha e lajmërimit për rreziqet konvencionale, si dhe angazhimi i komponentëve të tjerë të fuqisë kombëtare e kolektive para forcës ushtarake.

KREU IV

MISIONI, DETYRAT, NIVELI I AMBICIES (NIA) DHE KAPACITETET E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

4.1 Misioni i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë sigurojnë pavarësinë e vendit, si dhe mbrojnë tërësinë territoriale dhe rendin e tij kushtetues në Republikën e Shqipërisë. Misioni i Forcave të Armatosura është ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe tërësisë territoriale⁷ të vendit, në bashkëveprim me forcat aleate, mbrojtja dhe mbështetja e popullsisë në kohë paqeje, krize e lufte, kontributi për mbrojtjen kolektive, në kuadër të nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit⁸, si dhe paqen dhe sigurinë në rajon e më gjerë.

4.2 Detyrat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Për përmbushjen e misionit të tyre, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kryejnë këto detyra:

Në kohë paqeje:

- organizohen, trajnohen dhe pajisen për përmbushjen e detyrave në kohë lufte ose të operacioneve të emergjencave civile, sipas nevojës;

- zgjerimi i spektrit të angazhimeve të FA-së, në kushtet e paqes, në shërbim të qytetarëve dhe të autoriteteve civile;

- monitorojnë hapësirën tokësore, ajrore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur

kapacitete të integruara, në bashkëpunim me NATO-n dhe partnerë të tjerë, me qëllim që të sigurohet identifikimi në kohë i rreziqeve të mundshme ndaj sovranitetit të Republikës së Shqipërisë dhe integritetit territorial të saj;

- planëzojnë përdorimin e forcës, sipas nivelit të kërkuar të reagimit, në rast të cenimit të territorit të Republikës së Shqipërisë;

- përgatiten dhe sigurojnë mbështetjen e nevojshme për autoritetet qendrore e vendore dhe popullsinë në përballimin e emergjencave civile;

- përgatiten dhe kontribuojnë në operacione në mbështetje të paqes, të drejtuara nga NATO-ja, BE-ja, OKB-ja ose si pjesë e koalicioneve të ndryshme partnere;

- zhvillojnë kapacitete të ndërveprueshme, të nevojshme për të bashkëpunuar me strukturat kolektive të sigurisë euroatlantike;

- zhvillojnë dhe ofrojnë struktura dhe kapacitete ushtarake speciale, në përputhje me marrëveshjet ndërinstitucionale;

- planifikojnë masa për parandalimin e dëmtimit të mjedisit, për menaxhimin dhe mbrojtjen e tij gjatë veprimtarive ushtarake dhe veprojnë për eliminimin e dëmtimeve në mjedis, të koordinuara me marrëveshje ndërinstitucionale;

- bashkëpunojnë me strukturat e sigurisë publike për t'i mbështetur ato sipas kërkesës dhe kur lejohet me ligj;

- mbështesin pushtetin vendor në përballimin e nevojave jetike të komunitetit, sipas mundësive dhe kapaciteteve në dispozicion.

Në kohë krize:

- sigurojnë mbrojtjen e vendit dhe të popullsisë në rast kërcënimesh të jashtme ushtarake;

- sigurojnë mbështetjen e nevojshme për eliminimin e efekteve të katastrofave natyrore ose të shkaktuara nga njeriu;

- bashkëpunojnë dhe mbështetin strukturat e sigurisë publike, siç përcaktohet me ligj;

- koordinojnë dhe bashkëpunojnë me strukturat e tjera brenda dhe jashtë vendit për të parandaluar trafiket e paligjshme, kontrabandën dhe terrorizmin, siç përcaktohet me ligj;

- ofrojnë mbështetje si vend pritës për forcat aleate ose për forcat ushtarake të vendeve partnere, të cilat dislokohen në ndihmë të Shqipërisë.

Në kohe lufte:

- planëzojnë dhe kryejnë operacione ushtarake për të mbrojtur integritetin territorial të vendit;



- mbrojnë dhe mbështesin popullsinë e Republikës së Shqipërisë;

- bashkëpunojnë dhe koordinojnë me Forcat Ushtarake të NATO-s, në kuadër të mbrojtjes kolektive;

- sigurojnë mbështetjen si vend pritës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4.3 Niveli i Ambicies (NiA) i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

NiA e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë përcakton kapacitetet e dëshiruara ushtarake e civile për pjesëmarrje të njëhershme në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, më vete ose me aleatët, bazuar në kohëzgjatjen dhe rotacionet e mëtejshme të tyre.

NiA për mbrojtjen kombëtare është që Forcat e Armatosura të sigurojnë misionin kushtetues, sovranitetin dhe integritetin e vendit deri në aktivizimin e burimeve të tjera kombëtare dhe/apo aktivizimin e nenit 5 të Aleancës. Kontributi i Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen kolektive të territoreve të Aleancës, sipas procesit të Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s, është një grupim taktik “grup-batalion i këmbësorisë së lehtë të motorizuar”, me angazhim gjashtë muaj deri në një vit, pa rotacion të mëtejshëm, të konfiguruar sipas misionit konkret.

NiA për pjesëmarrje në operacione në përgjigje ndaj krizave, jashtë nenit 5 (NA5CRO). NiA e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për pjesëmarrje në operacione NA5CRO, jashtë nenit 5, kryhet mbi bazën e konceptit të “një grupimi të vetëm forcash” për NATO/BE/OKB apo koalicione të mundshme, përtej kufijve kombëtarë dhe aleatë. Kjo NiA është jo më shumë se tri kompani njëherësh në operacione me rotacion të vijueshëm. Pjesëmarrja mund të bëhet edhe me kapacitete të specializuara “Niche”, grupe të forcave speciale, si dhe ekspertë (civilë dhe ushtarakë) trajnues, këshillues, koordinatorë, vëzhgues etj., sipas sistemit të ponderimit, të pranuar nga Aleanca.

NiA për përballimin e emergjencave civile. NiA e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për përballimin e emergjencave civile, në mbështetje të autoriteteve të angazhuara në emergjenca civile brenda vendit, është mbështetja e një situatë emergjente të vetme me angazhimin e një njësie deri në dy batalione të përforcuara ose e dy situatave emergjente të njëkohshme, me

angazhimin e dy njësive deri në nivel batalioni të përforcuar. Kjo mbështetje për autoritetet civile qendrore dhe lokale kryhet kur kapacitetet e tyre janë të pamjaftueshme apo kur Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë sjellin ekspertizë të veçantë që nuk disponohet nga institucionet e tjera përgjegjëse.

4.4 Kapacitetet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Forcat e Armatosura zhvillojnë kapacitete të përshtatshme për t’iu përgjigjur të gjithë spektrit të rreziqeve ndaj vendit, si dhe përmbushjes së angazhimeve ndërkombëtare. Kapacitetet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ndahen në kapacitete të luftimit dhe në kapacitete të mbështetjes.

4.4.1 Kapacitetet e luftimit

Kapacitetet e luftimit përfaqësojnë aftësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të kryer operacione luftarake dhe joluftarake në plotësim të misionit. Ato realizohen prej njësive të luftimit, të cilat krijohen, organizohen, stërviten dhe pajisen për të qenë të gatshme për zhvillimin e operacioneve luftarake dhe joluftarake, brenda dhe jashtë vendit. Bazën e kapaciteteve të luftimit e përbëjnë njësitë e luftimit të Forcës Tokësore (batalionet e luftimit), ndërsa ato të forcave të tjera do të zhvillohen në kohë të përshtatshme, në përputhje me nivelin e rrezikut ndaj sigurisë kombëtare. Sasia e përgjithshme e autorizuar e personelit të kapaciteteve të luftimit planëzohet të jetë deri në një e treta e numrit të përgjithshëm të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4.4.2 Kapacitetet e mbështetjes

Kapacitetet e mbështetjes përfaqësojnë aftësitë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të mbështetur operacionet luftarake dhe joluftarake në plotësim të misionit. Ato realizohen nga njësitë e mbështetjes së luftimit dhe njësitë e mbështetjes me shërbime të luftimit. Kapacitetet e mbështetjes së luftimit përbëhen nga kapacitetet e mbështetjes me fuqi zjarri dhe kapacitetet që ofrojnë ndihmë operacionale të elementeve të luftimit, të tilla si: kapacitetet e inteligjencës, sigurisë, MADM, xhenios luftuese dhe komandim-kontrollit e komunikimit. Kapacitetet e mbështetjes me shërbime të luftimit sigurojnë mbështetjen e përgjithshme për të gjitha Forcat e Armatosura, kryesisht në fushën logjistike. Në këto kapacitete



hyjnë kapacitetet e furnizimit, transportit, mirëmbajtjes, kujdesit shëndetësor, kujdesit psikologjik dhe të administrimit. Sasia e përgjithshme e personelit të autorizuar e kapaciteteve të mbështetjes planëzohet të jetë deri në dy të tretat e numrit të përgjithshëm të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4.5 Struktura dhe organizimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëhen nga forca tokësore, detare, ajrore, si dhe strukturat mbështetëse. Forcat e Armatosura organizohen dhe funksionojnë si një strukturë e bashkuar e kapaciteteve të forcave tokësore, forcave detare, forcave ajrore dhe atyre mbështetëse, për të realizuar me efektivitet misionin. Miratimi i strukturës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë bëhet sipas linjës së hierarkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4.5.1 Organizimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Organizimi strukturor i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë realizohet sipas një sistemi linear hierarkik, i cili siguron komandim-kontrollin e unifikuar të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në krye të strukturave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë qëndron Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe në krye të forcave respektive dhe strukturave mbështetëse qëndrojnë komandantët, të cilët mbështeten nga shtabe ose struktura ndihmëse në ushtrimin e autoritetit komandues.

4.5.2 Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është struktura organizative më e lartë ushtarake në Forcat e Armatosura. Misioni i Shtabit të Përgjithshëm është planifikimi, zhvillimi e komandim-kontrolli strategjik i Forcave të Armatosura, me komponentin tokësor, detar e ajror, si dhe strukturat e tjera mbështetëse, të afta për të plotësuar misionin e tyre kushtetues.

4.5.3 Komandat kryesore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë organizohen dhe kanë në përbërjen e tyre Komandën e Forcës Tokësore, së bashku me

strukturat e varësisë, Komandën e Forcës Detare, së bashku me strukturat e varësisë, Komandën e Forcës Ajrore, së bashku me strukturat e varësisë dhe Komandat e Strukturave Mbështetëse, së bashku me strukturat e varësisë së tyre. Komandat dhe strukturat e varësisë së tyre organizohen, trajnohen dhe pajisen për realizimin e misionit dhe detyrave në kohë paqeje, krize dhe lufte.

4.5.4 Strukturat e drejtimit dhe komandim-kontrollit dhe parimet bazë

Drejtimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në nivelin politik-strategjik ushtrohet nga Kuvendi i Shqipërisë, Presidenti i Republikës, Kryeministri dhe ministri i Mbrojtjes, të specifikuar me ligj të veçantë.

Komandim-kontrolli në nivelin ushtarak-strategjik ushtrohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Komandim-kontrolli operacional i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kohë paqeje, realizohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ndërsa në kohë lufte nga Komandanti i Forcave të Armatosura.

Drejtimi dhe komandim-kontrolli operacional mbështetet në këto parime bazë: kontrolli civil i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, paanshmëria politike e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, komandimi i unifikuar i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe zbatimi i hierarkisë në zinxhirin e komandimit.

KREU V

MBËSHTETJA ME BURIME TË MBROJTJES E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Mbështetja me burimet e mbrojtjes përfshin burimet njerëzore, burimet materiale/logjistike dhe burimet financiare.

5.1 Burimet njerëzore dhe konsolidimi i forcës profesionale

Burimet njerëzore janë pjesa më e rëndësishme dhe më aktive e burimeve të mbrojtjes. Ushtarët, nënoficerët, oficerët, aktivë e në rezervë, si dhe punonjësit civilë janë aset më i rëndësishëm, si dhe prioritet i parë i Forcave të Armatosura.

Konsolidimi i forcës profesionale nënkupton një forcë cilësore të motivuar, të trajnuar, të pajisur dhe të ndërveprueshme me forcat aleate.



Zhvillimi i forcës profesioniste ka në themel një sistem cilësor të rekrutimit të personelit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet politikave dhe strategjive që mbështeten në vlera, si dhe në përfitimet dhe në garancitë sociale për personelin dhe familjet.

Ky sistem u garanton shanse të barabarta të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim race, gjinie e përkatësie, si dhe trajtim dinjitoz të tyre, gjatë gjithë karrierës dhe pas saj.

Rekrutimi i personelit ushtarak bëhet i përqendruar nën një autoritet të vetëm, duke zbatuar norma e standarde të mirëpërcaktuara. Synimi të jetë rritja e cilësisë në rekrutimin e kandidatëve që dëshirojnë të shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura, duke tentuar përzgjedhjen e kandidatëve me nivel më të lartë arsimimi. Objektiv parësor të jetë rekrutimi në raporte të drejta përfaqësimi gjinor, duke mos ndikuar në nivelin e gatishmërisë së kapaciteteve luftarake.

5.2 Burimet logjistike

Veprimtaria dhe operacionet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të mbështetet me kapacitete logjistike, bazuar në konceptin e mbështetjes logjistike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe doktrinat e Aleancës.

5.2.1 Koncepti i mbështetjes logjistike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Koncepti i mbështetjes logjistike synon në plotësimin e kërkesave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe përmbushjen e nivelit të ambicies në operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet sigurimit dhe përdorimit efektiv të burimeve logjistike.

Mbështetja logjistike në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë zbatohet sipas parimit nga lart poshtë, i cili siguron efektshmëri maksimale të sistemit të mbështetjes logjistike në përdorimin e burimeve në dispozicion. Kjo realizohet nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve të nevojshme logjistike, krijimit të rezervës së domosdoshme dhe sigurimit e mëvetësisë operacionale për strukturat që angazhohen drejtpërdrejt në operacione.

Sigurimi i sasisë së mjaftueshme të burimeve të mbrojtjes dhe standardizimi i tyre përfshin të gjitha fushat e mbështetjes logjistike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Sigurimi i burimeve logjistike cilësore dhe në kohën e duhur, për mbështetjen e veprimtarisë së

Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, bëhet nëpërmjet një ndërthurjeje efektive të sektorit shtetëror me atë privat.

5.2.2 Infrastruktura

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të administrojnë, do të zhvillojnë dhe do të mirëmbajnë një infrastrukturë të mjaftueshme e bashkëkohore për jetesë, stërvitje e komandim-kontroll të njësisë, reparteve e nënreparteve për funksionimin normal të tyre në kohë paqeje, krize e luftime. Kjo do të arrihet nëpërmjet: përqendrimit të garnizoneve kryesore, me synim krijimin e një numri më të vogël, por më të efektshëm; ndërtimit të objekteve të reja dhe të përshtatjes së atyre ekzistuese, sipas standardeve bashkëkohore; ndërtimit të poligoneve të reja dhe rikonstruksionit të atyre ekzistuese, me synim krijimin e kushteve bashkëkohore për stërvitjen e efektivave; si dhe zhvillimit të kapaciteteve të vendit pritës.

5.2.3 Rezerva logjistike

Sigurimi dhe mbajtja e rezervës së nevojshme logjistike do të bëhet duke u bazuar në sistemin e gatishmërisë, operacioneve dhe të stërvitjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas konceptit të NATO-s, duke përfshirë të gjitha fushat e mbështetjes me shërbime dhe të gjitha klasat e furnizimit.

5.3 Burimet financiare

Burimet financiare për mbështetjen e shpenzimeve të mbrojtjes sigurohen nga buxheti i shtetit për mbrojtjen dhe nga programet e bashkëpunimit ushtarak.

5.3.1 Buxheti i mbrojtjes

Për të garantuar konsolidimin e forcës së ardhshme profesioniste në periudhën afatmesme dhe për të ndërtuar kapacitetet e domosdoshme, që mundësojnë plotësimin e misionit dhe të NiA-s, kjo strategji mbështet një buxhet të mbrojtjes në nivelet e kërkuara në përmbushje të vendimeve të Samitit të NATO-s në Uells, buxheti i mbrojtjes nuk do të ulet poshtë nivelit aktual, si dhe do të përdoret me efektivitetin më të lartë. Njëkohësisht do të synohet një rritje graduale në raport me rritjen e GDP-së, për të arritur në nivelin 2 për qind, brenda një periudhe 10-vjeçare.¹⁰

Përdorimi i burimeve të mbrojtjes në Forcat e Armatosura do të bëhet në mënyrë të balancuar ndërmjet tri kategorive kryesore të shpenzimeve (për personelin, për operacionet dhe për mirëmbajtjen, si dhe për investimet), për të siguruar



një zhvillim harmonik e të integruar të të gjitha fushave të mbrojtjes. Në dhjetë vitet e ardhshme do të synohet që shpenzimet për investime dhe pajisje e armatim të rriten deri në 20 për qind të buxhetit të mbrojtjes, sikurse është pranuar edhe në Deklaratën e Samitit të Uellsit¹.

5.3.2 Mbështetja në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak

Mbështetja në kuadrin e bashkëpunimit ushtarak do të synojë programe/projekte në funksion të realizimit të objektivave të forcës; trajnimit, stërvitjeve, vlerësimit të njësisive dhe arsimimit të personelit ushtarak dhe civil të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë; rritjes dhe konsolidimit të kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë; mbështetje të pjesëmarrjes në operacione të drejtuara nga NATO-ja/BE-ja/OKB-ja; rritjes së cilësisë së përfaqësimit me personel trajnues në misione dhe oficerë shtabi të të gjitha niveleve.

PËRFUNDIME

Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë sjell ndryshime të thella në konceptin strategjik të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit tonë. Ajo na orienton si të mendojmë, të organizohemi, të trajnohemi, të pajisemi dhe si të ndërveprojmë në këtë kontekst të ri.

Strategjia Ushtarake reflekton në mënyrë realiste mesazhet e iniciuara nga Koncepti Strategjik i NATO-s, mesazhet e samiteve të radhës të Aleancës, detyrimet që rrjedhin nga SSK-ja, si dhe nga gjetjet e rekomandimet e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, 2013.

Strategjia Ushtarake do të mbështetet me plane e programe të studiuara mirë për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme e për vënien e saj në praktikë.

Strategjia Ushtarake do të rishikohet, si rregull, pas pesë vjetësh, në varësi të zhvillimeve të sigurisë e të mbrojtjes, brenda dhe jashtë vendit.

SHKURTIME

RSH - Republika e Shqipërisë

FARSH - Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë

NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

BE - Bashkimi Evropian

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

MM - Ministria e Mbrojtjes

SHPFA - Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

SSK - Strategjia e Sigurisë Kombëtare

NiA - Niveli i Ambicies

NA5CRO - Operacionet në Përgjigje të Krizave jashtë nenit 5

STANAG - Marrëveshje Standardizimi të Aleancës

RSM - Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes

PBK - Planifikimi i Bazuar në Kapacitete

SPI - Sistemi i Planifikimit të Integruar

¹ Koncepti Strategjik i Aleancës, Lisbonë, nëntor 2010, miratuar nga kryetarët e shteteve dhe të qeverive të 28 vendeve të Aleancës.

² Termi “Kapacitet” nënkupton zhvillimin e aftësive luftarake të njësisive të Forcave të Armatosura mbi bazën e 8 elementeve: doktrinë, organizim, trajnim, pajisje e sisteme, arsimim, lidhshmëri, personel, infrastrukturë dhe ndërveprim.

³ Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit shprehet se “... Palët bien dakord se një sulm i armatosur kundër një apo më shumë prej tyre në Evropë apo në Amerikën e Veriut, do të konsiderohet si sulm kundër të gjitha Palëve, dhe si pasojë bien dakord që, nëse ndodh një sulm i tillë, secila nga ato, në ushtrim të së drejtës së vetëmbrojtjes kolektive apo individuale, të njohur nga neni 51 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, do të ndihmojë Palën apo Palët e sulmuara, duke ndërmarrë menjëherë, individualisht dhe në bashkërendim me Palët e tjera, ato veprime që vlerësohen si të nevojshme, përfshirë këtu përdorimin e forcave të armatosura, për të rivendosur dhe për të ruajtur sigurinë në zonën e Atlantikut të Veriut”.

⁴ “EU Common Security and Defence Policy”, politika e përbashkët e sigurisë dhe e mbrojtjes së BE-së.

⁵ “Smart Defence”, iniciativë e Aleancës me origjinë Samitin e Lisbonës 2010. Ajo është një formë e re e të menduarit dhe e planifikimit për gjenerimin e kapaciteteve moderne të mbrojtjes për nevojat e Aleancës për dekadën e ardhshme dhe më tej.

⁶ Në Samitin e NATO-s, më 2004-n, është marrë angazhimi politik nga ministrat e Mbrojtjes, i njohur si angazhimi “40-8 usability target”, i cili nënkupton që 40 për qind të forcës tokësore të jetë e organizuar, e stërvitur dhe e pajisur për t’u dislokuar në operacionet e drejtuara nga NATO-ja dhe 8 për qind e saj të jetë në operacion ose e gatshme për t’u dislokuar në çdo kohë që i kërkohet.



⁷ a) Sovraniteti. Sovraniteti është statusi ligjor që shpreh të drejtën e zotërimit të autoritetit suprem dhe të pavarur për të bërë dhe për të zbatuar ligjin dhe për të ushtruar kontrollin e popullsisë në një territor apo zonë gjeografike të caktuar, autoritet që njihet nga shtetet e tjera sovrane si zotërues dhe bartës i vetëm i kësaj të drejte. Në shtetet e demokracisë parlamentare, autoriteti sovran është parlamenti;

b) Tërësia territoriale, sipas së drejtës ndërkombëtare, është parimi që shpreh se territori që përfshihet brenda kufijve të përcaktuar e të njohur ndërkombëtarisht nën sovranitetin e një shteti të caktuar, është një dhe i pandashëm. Tërësia territoriale përfshin hapësirën tokësore, detare dhe ajrore. Ushtrimi i forcës për ndryshimin e kufijve të territorit përbën një akt agresioni;

c) Pavarësia e një shteti është e drejta politike e tij për të ushtruar pushtet politik në të gjithë territorin dhe popullsinë që banon brenda kufijve të përcaktuar e të njohur ndërkombëtarisht, duke qenë i pavarur nga influenza, kontrolli apo vendimmarrja e shteteve të tjera.

⁸ Neni 5 i Traktatit të Uashingtonit (*Article 5 "The Parties agree that an armed attack against one or more of them in Europe or North America shall be considered an attack against them all and consequently they agree that, if such an armed attack occurs, each of them, in exercise of the right of individual or collective self-defence recognised by Article 51 of the Charter of the United Nations, will assist the Party or Parties so attacked by taking forthwith, individually and in concert with the other Parties, such action as it deems necessary, including the use of armed force, to restore and maintain the security of the North Atlantic area. Any such armed attack and all measures taken as a result thereof shall immediately be reported to the Security Council. Such measures shall be terminated when the Security Council has taken the measures necessary to restore and maintain international peace and security."*).

⁹ Kapacitete "Niche" janë kapacitete të vogla, të specializuara, që kryejnë funksione të unifikuara në njësi shumëkombëshe. Këto kapacitete janë përtej njësive/formacioneve tradicionale. Ato krijohen nga vendet aleate mbi bazën e traditës, eksperiencës, veçorive dhe mundësive të tyre. Të tilla mund të përmendim, ndër të tjera, si ekipe EOD (asgjësimi i municioneve të rrezikshme), CIED (pajisje kundër eksplozivëve të improvizuar), NBRC (masa kundër armëve të shkatërrimit në masë, nukleare, biologjike, radiologjike dhe kimike),

OMLT (ekipe për trajnim dhe këshillim operacional), POMLT (ekipe për trajnim dhe këshillim policor), CIMIC (marrëdhënie civile-ushtarake), MP (polici ushtarake), MAT (ekipe të këshillimit ushtarak) etj.

¹⁰ Pika 14 e Deklaratës së Përbashkët të Kryetarëve të Shteteve në Samitin e Uellsit (*Wales Summit Declaration, Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Wales, Press Release (2014) 120, Issued on 05 Sep. 2014*).

¹¹ Po aty.

LIGJ

Nr. 74/2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE
NDËRMJET MINISTRISË SË
FINANCIVE, SI AUTORITET
KONTRAKTUES, DHE SHOQËRIVE "S2
ALBANIA", SH.P.K., DHE "RAPISCAN
SYSTEMS", INC "PËR ZGJIDHJEN ME
MIRËKUPTIM TË
MOSMARRËVESHJEVE" DHE "PËR
NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË
KONCESIONIT PËR FINANCIMIN,
NGRITJEN DHE OPERIMIN E
SHËRBIMIT TË SKANIMIT TË
KONTEJNERËVE E AUTOMJETEVE TË
TJERA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË,
MIRATUAR ME LIGJIN NR. 123/2013", SI
DHE TË TARIFËS SË SHËRBIMIT TË
SKANIMIT**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohen marrëveshjet ndërmjet Ministrisë së Financive, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive "S2 Albania", sh.p.k., dhe "Rapiscan Systems", INC "Për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve" dhe "Për ndryshimin e marrëveshjes së koncesionit për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 123/2013", të



datës 28 prill 2015, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij projektligji.

Neni 2

1. Tarifa e shërbimit të skanimit për deklaratat doganore, me vlerë nën ose të barabartë me 1 000 (një mijë) euro, do të jetë 5 (pesë) euro për deklaratë doganore ose vlera përkatëse në lekë, konvertuar sipas procedurave doganore.

2. Tarifa e shërbimit të skanimit për deklaratat doganore, me vlerë më të madhe se 1 000 (një mijë) euro, do të jetë 22 (njëzet e dy) euro për deklaratë doganore ose vlera përkatëse në lekë, konvertuar sipas procedurave doganore.

3. Shërbimi i skanimit të kontejnerëve dhe automjeteve të tjera trajtohet si furnizim i tatueshëm me TVSH me shkallë tatimore 0 (zero).

4. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa, sipas këtij neni, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 3

Neni 2 i ligjit nr. 123/2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërisë “Rapiscan Security, INC.”, si koncesionar, për financimin, ngritjen dhe operimin e shërbimit të skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe tarifës së shërbimit të skanimit” shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 9.7.2015

MARRËVESHJE **PËR ZGJIDHJEN ME MIRËKUPITIM TË** **MOSMARRËVESHJEVE**

Datë 28 prill 2015

NDËRMJET:

1. S2 ALBANIA SHPK (më poshtë referuar si S2), e regjistruar në Tiranë, Shqipëri me NIPT nr. L31722010Q, më poshtë e përfaqësuar nga Jonathan Fleming, në moshë madhore, Presidenti i S2 dhe banues në Shtetin e Floridas, SHBA; dhe

2. RAPISCAN SYSTEMS, INC. (më poshtë e referuar si RAPISCAN), me numër identifikimi punëdhënësi 954-41-3488, një shoqëri e themeluar

sipas ligjeve të Kalifornisë, SHBA, më poshtë e përfaqësuar nga Jonathan Fleming, në moshë madhore, Zëvendës-president i RAPISCAN dhe banues në Shtetin e Floridas, SHBA,

(bashkërisht të referuar si Paditësit).

3. Ministrisë së Financave, e cila vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, e autorizuar në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 2.11.2011, e përfaqësuar nga ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqim Cani (I Padituri),

(bashkërisht të referuara si Palët).

HISTORIKU

A) Palët kanë zhvilluar kohët e fundit diskutime në përputhje me Marrëveshjen e Konfidencialitetit, të datës 20 shkurt 2015 (Marrëveshja e Konfidencialitetit), në lidhje me: i) Marrëveshjen e Koncesionit, të datës 10 prill 2013 (Marrëveshja e Koncesionit); dhe ii) mosmarrëveshjen, e cila është aktualisht në procedim para ICC-së (Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë) në lidhje me Marrëveshjen e Koncesionit (Çështja ICC nr. 20447/MHM) (Arbitrazhi) dhe, si rezultat i këtyre diskutimeve, kanë rënë dakord që: i) të gjejnë zgjidhje për Arbitrazhin (Marrëveshja për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve); ii) të amendojnë Marrëveshjen e Koncesionit (Marrëveshja e Amendimit), siç përcaktohet në shtojcën A; dhe iii) të gjejnë zgjidhje për të gjitha mosmarrëveshjet, pretendimet, shkaqet për pretendime dhe/ose përgjegjësitë midis palëve që rrjedhin nga faktet ose ngjarjet ekzistuese ose që kanë ndodhur përpara Datës së Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, qoftë të njohura apo të panjohura (duke përfshirë çdo detyrim që pretendohet se ka lindur nga Marrëveshja e Koncesionit e datës 10 prill 2013) në përputhje me kushtet e përcaktuara më poshtë dhe me kushtet e dokumentit të bashkëlidhur këtu si aneksi A.

B) Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, procedura e arbitrazhit do të pezullohet.

KUSHTET E MARRËVESHJES

1. Palët bien dakord që të amendojnë Marrëveshjen e Koncesionit sipas kushteve të përcaktuara në shtojcën A më poshtë (Marrëveshja e Amendimit).

2. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve:



a) Marrëveshja e Amendimit dhe Marrëveshja për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve do të dërgohen menjëherë pranë Këshillit të Ministrave të Shqipërisë dhe të Kuvendit të Shqipërisë për miratim dhe ratifikim, në përputhje me nenet 2.1 dhe 3.1 të Marrëveshjes së Amdendimit, si dhe nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje;

b) Brenda dy ditësh pune, pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, Palët bashkërisht do t'i kërkojnë Gjykatës që të pezullojë Arbitrazhin me efekt të menjëhershëm;

c) Kjo Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve do t'i nënshtrohet së njëjtës rregull mbi konfidencialitetin, të përcaktuar në Marrëveshjen e Konfidencialitetit; sidoqoftë, me kusht që detyrimi i një pale për konfidencialitet nuk do të zbatohet për:

- i) informacionin, i cili është në dispozicion të publikut; dhe
- ii) informacionin, i cili kërkohet të bëhet publik në bazë të një ligji ose nga ligjet e zbatueshme për atë palë.

3. Data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve do të jetë 15 ditë kalendarike pas datës së botimit në Fletoren Zyrtare në Shqipëri, të ligjeve përkatëse, të cilat miratojnë marrëveshjen e amendimit dhe të ketë Marrëveshje për zgjidhjen me mirëkuptim të mosmarrëveshjeve (Data e Hyrjes në Fuqi).

4. Kushtet e mëposhtme duhet të përmbushen para ose në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë duhet të ketë marrë vendimin për miratimin e kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve; dhe

b) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duhet të ketë miratuar këtë Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve dhe ky miratim të ketë hyrë në fuqi.

5. Kjo Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve hyn në fuqi me kusht që Data e Hyrjes në Fuqi të jetë më 31 tetor 2015 ose para kësaj date (kjo datë mund të ndryshohet në një datë të mëvonshme me marrëveshje midis palëve). Në rast se ky kusht nuk plotësohet, përveç rastit kur është rënë dakord

ndryshe me shkrim nga Palët, kjo Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve do të humbë të gjitha efektet ligjore, sikur të mos ishte lidhur asnjëherë, me përjashtim të dispozitave për konfidencialitetin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe ligjin e zbatueshëm.

6. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve:

a) Në përputhje me nenin 6/c, kjo Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve do të përbëjë zgjidhjen e plotë dhe përfundimtare të të gjitha mosmarrëveshjeve, pretendimeve, shkaqeve për pretendime, dhe/ose përgjegjësi (duke përfshirë Arbitrazhin) ndërmjet palëve që rrjedhin nga faktet ose ngjarjet ekzistuese apo të ndodhura para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, qoftë të njohura apo të panjohura, dhe secila nga palët në këtë kohë do të çlirojë dhe do të shkarkojë përgjithmonë palët e tjera nga çdo përgjegjësi për të gjitha pretendimet dhe shkaqet për pretendime që secila nga palët ka ndaj të tjerëve në Datën e Hyrjes në Fuqi, duke përfshirë, për shmangien e çdo dyshimi, edhe Arbitrazhin dhe çdo mosmarrëveshjeje apo çështje të lidhur me Marrëveshjen e Koncesionit të datës 10 prill 2013;

b) Jo më vonë se dy javë pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, Palët do të njoftojnë Gjykatën që shqyrton Arbitrazhin që procedimet janë ndërprerë dhe do të kërkojnë një urdhër për shpenzimet, në përputhje me nenin 6/c më poshtë;

c) Paditësit do të përballojnë shpenzimet për Gjykatën dhe ICC-në. Të gjitha shpenzimet e tjera të Arbitrazhit, duke përfshirë kostot e përfaqësimit ligjor do të mbulohen nga Pala, e cila i ka shkaktuar ato;

d) Secila Palë merr përsipër, në bazë të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, angazhimin që të mos fillojë apo ndërmarrë ose të ndihmojë vullnetarisht apo të shkarkojë fillimin ose ndërmarrjen ndaj çdo pale tjetër, të çdo veprimi, padie apo procedimi tjetër në lidhje me pretendimet e zgjidhura nga kjo Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, në çdo juridiksion.



7. Në rast se Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve nuk ndodh në ose para datës 31 tetor 2015 (kjo datë mund të ndryshohet duke përcaktuar një datë të mëvonshme me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet palëve), secila Palë do të ketë të drejtën të kërkojë heqjen dorë nga pezullimi i Arbitrazhit pa iu drejtuar Palës tjetër dhe do të ketë të drejtën e çdo mjeti juridik që do të kishte pasur sikur Marrëveshja për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve të mos ishte lidhur.

8. Kjo Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve përmban të gjitha kushtet për të cilat kanë rënë dakord Palët në lidhje me objektin e saj dhe ka përparësi mbi çdo marrëveshje, përfaqësim apo ujdë të mëparshme të Palëve të bëra me shkrim ose me gojë, në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje.

9. Secila Palë njeh dhe pranon që kjo Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve nuk është nënshkruar duke u bazuar plotësisht apo pjesërisht në deklarata, premtime apo deklarime të cilat nuk janë përcaktuar shprehimisht në këtë Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve dhe të bëra nga ose në emër të palës tjetër. Asgjë në këtë Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve nuk do të përjashtojë asnjë përgjegjësi që një nga Palët do të kishte ndaj palës tjetër në lidhje me ndonjë deklaratë të bërë me anë të mashtrimit.

10. Secila Palë garanton që paraprakisht nuk ka ngarkuar, caktuar apo përdorur në çfarëdo lloji mënyrë, si dhe bie dakord që nuk do të ngarkojë, caktojë apo përdorë në çfarëdo lloji mënyrë, pa pëlqimin e Palëve të tjera (ky pëlqim nuk duhet të tërhiqet pa arsye) asnjë interes në pretendimet e zgjidhura nga kjo Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, si dhe në çdo pretendim ekzistues apo të mundshëm të çfarëdo lloji, i cili është ose ka qenë ose mund të jetë ose mund të lindur nga ose që në ndonjë mënyrë lidhet me pretendimet e zgjidhura nga kjo Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve ndaj palës tjetër.

11. Secila Palë garanton dhe deklaron te Pala tjetër që është autorizuar në mënyrë të rregullt për të nënshkruar, për të dorëzuar dhe për të zbatuar këtë marrëveshje.

12. I Padituri garanton që hapat e përcaktuar në nenet 2, 3 dhe 4 përfaqësojnë të gjitha veprimet ligjore që duhet të ndërmerren për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe zbatimin e Marrëveshjes për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve dhe Marrëveshjes së Amendimit, dhe se këta hapa do të ndërmerren në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme.

13. I Padituri garanton që pas përmbushjes së hapave të përcaktuar në nenet 2, 3 dhe 4, të dyja, Marrëveshja për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve dhe Marrëveshja e Amendimit do të jenë të vlefshme, të detyrueshme dhe të zbatueshme për të Paditurin në përputhje me ligjet e zbatueshme ndaj tij. Gjithashtu, i padituri garanton që Marrëveshja e Koncesionit, siç është amenduar nga Marrëveshja e Amendimit, do të jetë e vlefshme, e detyrueshme dhe e zbatueshme për të Paditurin sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

14. Kjo Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve dhe çdo detyrim jokontraktual që lind nga ose në lidhje me të do të rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nga dispozitat ligjore mbi legjislacionin e zbatueshëm.

15. Dispozitat e neneve 21.13 (Asnjë Palë e Tretë Përfituese), 21.16 (Ligji i zbatueshëm dhe Vendi i zhvillimit të Gjykimit) dhe 21.17 (Heqja Dorë nga Imuniteti) të Marrëveshjes së Koncesionit do të zbatohen, *mutatis mutandis* në këtë Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve.

16. Secila Palë do të përballojë shpenzimet e veta në lidhje me përgatitjen dhe negocimin e kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve dhe Marrëveshjes së Amendimit.

17. Nëse ndonjë Gjykatë ose organ i autoritetit të juridiksionit kompetent vendos se ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve është e paligjshme, në kundërshtim me ligjin, e pavlefshme ose e pazbatueshme, kjo dispozitë do të konsiderohet e ndarë nga kjo Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve dhe nuk do të ketë ndikim mbi pjesën tjetër të kësaj Marrëveshjeje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, e cila do të vazhdojë të ketë fuqi dhe efekt të plotë.



18. Kjo Marrëveshje për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve do të nënshkruhet në disa kopje, ku secila prej tyre pas nënshkrimit do të jetë një kopje origjinale dhe të gjitha do të përfaqësojnë të njëjtin dhe të vetmin dokument.

Në dëshmi të sa më sipër, palët nënshkruajnë këtë Marrëveshje për Zgjidhjen e Pretendimeve në datën e caktuar më lart.

AUTORITETI

Nga:

Shkëlqim Cani

Ministër

RAPISCAN SYSTEMS, INC.

Nga:

Jonathan Fleming

Zëvendës-president

S2 ALBANIA SHPK

Nga:

Jonathan Fleming

President

MARRËVESHJE

PËR AMENDIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT

Kjo Marrëveshje për Amendimin e Marrëveshjes së Koncesionit (kjo Marrëveshje Amendimi) është lidhur dhe nënshkruar më 28 prill 2015, ndërmjet:

1. Ministrisë së Financave, duke vepruar në emër të Republikës së Shqipërisë, sipas autorizimit të dhënë me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 755, datë 2.11.2011, e referuar si “Autoriteti”, e përfaqësuar nga Ministri i Financave i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqim Cani;

2. RAPISCAN SYSTEMS, INC. (më poshtë e referuar si RAPISCAN), me numër identifikimi punëdhënësi 954-41-3488, shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Kalifornisë, SHBA, më poshtë e përfaqësuar nga Jonathan Fleming, në moshë madhore, Zëvendës-president i RAPISCAN-it dhe banues në Shtetin e Floridas, SHBA;

3. S2 ALBANIA SHPK më poshtë e referuar si S2, regjistruar në Tiranë, Shqipëri me NIPT nr. L31722010Q, më poshtë e përfaqësuar nga Jonathan Fleming, në moshë madhore, Presidenti i S2 dhe banues në Shtetin e Floridas, SHBA,

(bashkërisht të referuara si Palët).

HYRJE

Duke marrë në konsideratë se Autoriteti dhe RAPISCAN kanë nënshkruar një Marrëveshje Koncesioni, në datën 10 prill 2013, e cila u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin 123/2013 (më poshtë e referuar si Marrëveshja);

duke marrë në konsideratë se Marrëveshja u transferua më 7 korrik 2013 nga RAPISCAN te S2 sipas klauzolës 5.1 të Marrëveshjes;

duke marrë në konsideratë se RAPISCAN vazhdon të jetë garantues i S2 sipas nenit 5.1 të Marrëveshjes;

duke marrë në konsideratë se në përputhje me nenin 13.1 të Marrëveshjes “Data e Hyrjes në Fuqi” e Marrëveshjes ishte 2 korrik 2013;

duke marrë në konsideratë se palët tashmë dëshirojnë të amendojnë kushtet e Marrëveshjes në bazë të nenit 21.1 të marrëveshjes, siç përcaktohet në këtë Marrëveshje Amendimi.

TERMAT DHE KUSHTET

1. PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

1.1 Fjalët dhe shprehjet e përcaktuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim të përdorur në këtë Marrëveshje Amendimi, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.

1.2 Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje Amendimi, fjalia e mëposhtme ka kuptimin si vijon:

a) “Data e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Amendimit” do të thotë data që bie 15 ditë kalendarike pas botimit në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë të ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshje Amendimi dhe që nuk duhet të jetë një datë më e hershme se data e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 2.1.

1.3 Me qëllim shmangien e çdo dyshimi, rregullat për interpretimin dhe rregullat në lidhje me amendimin në përmbajtje të Marrëveshjes, në nenet 21.1, 21.4, 21.5, 21.8 dhe 21.23 të Marrëveshjes do të zbatohen edhe për këtë Marrëveshje Amendimi.

2. KUSHTET PARAPRAKE

2.1 Kushtet e mëposhtme duhen të përmbushen para ose në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje Amendimi:

a) Këshilli i Ministrave i Shqipërisë duhet të ketë miratuar me vendim këtë Marrëveshje Amendimi;

b) Kuvendi i Republikës së Shqipërisë duhet të ketë miratuar këtë Marrëveshje Amendimi dhe ky



miratim duhet të ketë hyrë në fuqi.

2.2 Përveç kur është rënë dakord ndryshe me shkrim nga Palët, nëse Data e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje Amendimi nuk ndodh para ose në datën 31 tetor 2015 (kjo datë mund të ndryshohet në një datë të mëvonshme me marrëveshje midis palëve), kjo Marrëveshje Amendimi do të zgjidhet dhe të pushojë së pasuri efekt.

3. DETYRIMET E AUTORITETIT

3.1 Autoriteti duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për të garantuar se kushtet e përcaktuara në nenin 2.1, si dhe data e botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit përkatës që miraton këtë Marrëveshje Amendimi, në çdo rast do të përmbushen sa më shpejt të jetë e mundur dhe gjithsesi, brenda datës 31 tetor 2015 (kjo datë mund të ndryshohet në një datë të mëvonshme me marrëveshje të ndërsjellë midis palëve).

3.2 Autoriteti duhet të njoftojë RAPISCAN dhe S2 mbi Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje Amendimi dhe mbi përmbushjen e kushteve të përcaktuara në nenin 1.2/a dhe nenin 2.1, në secilin rast, brenda 7 ditëve nga përmbushja.

4. DETYRIMET E S2

4.1 Në bazë të nenit 9.2 të Marrëveshjes së Koncesionit, S2 do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme që të provojë gatishmërinë për fillimin e operimeve në Vendin e Portit të Durrësit, në përputhje me nenin 9.5 të marrëveshjes, brenda 10 ditësh pune nga Data e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Amendimit.

4.2 Në varësi të faktit se kur ndodh Data e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Amendimit, S2 do të provojë gatishmërinë për fillimin e operimeve në përputhje me nenin 9.5 të Marrëveshjes për të pesta Vendet (më poshtë i referuar si “Konfirmimi i Instalimit”). Në bazë të nenit 9.2 të Marrëveshjes së Koncesionit dhe përveç kur bihet dakord ndryshe me shkrim nga Palët, Konfirmimi i Instalimit do t’i njoftohet Autoritetit, jo më vonë se një vit nga Data e Fillimit të Operacioneve (Afati i Instalimit).

5. AMENDIMET E MARRËVESHJES

5.1 Duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi e Marrëveshjes së Amendimit, Marrëveshja do të ndryshohet si me poshtë:

a) Duke hequr nenin 1.3 të Marrëveshjes dhe duke shtuar një nen të ri 1.3 të marrëveshjes si vijon:

“1.3 “Data e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Amendimit” do të thotë data e përcaktuar në nenin 1.2/a të Amendimit të Marrëveshjes së Koncesionit, të datës 28 prill 2015, e cila amendon kushtet e kësaj Marrëveshjeje (Marrëveshja e Amendimit).”

b) Duke zëvendësuar në të gjithë Marrëveshjen termin “Data e Hyrjes në Fuqi” me termin “Data e Hyrjes në Fuqi e Marrëveshjes së Amendimit”, pa cenuar dispozitat e Marrëveshjes, të cilat tashmë janë përmbushur në referim të termit “Data e Hyrjes në Fuqi” dhe pa bërë përgjegjëse asnjë nga palët për vonesat në lidhje me zbatimin e çdo dispozite që i referohet “Datës së Hyrjes në Fuqi.”

c) Duke fshirë në fjalinë e parë të nenit 1.8 të Marrëveshjes dhe duke e zëvendësuar me fjalinë si më poshtë:

“1.8 “Data e Fillimit të Operacioneve” do të thotë dita e parë e muajit kalendarik që bie menjëherë pas datës në të cilën S2 i provon Autoritetit, në përputhje me nenin 9.5 të Marrëveshjes, se Vendi në Portin e Durrësit është gati për operimin, pavarësisht nga ndonjë certifikim i mëparshëm, certifikim për të cilin S2 duhet të bëjë të gjitha përpjekjet që ta dërgojë brenda 10 ditësh pune nga Data e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Amendimit, në pajtim me nenin 9.2 të Marrëveshjes së Koncesionit.”

d) Duke shtuar një nen të ri 1.13 në Marrëveshje, si vijon:

“1.13 “Data e Fillimit të Funkcionimit të Vendit” do të thotë dita e parë e muajit kalendarik që bie menjëherë pas datës në të cilën S2 provon, në përputhje me nenin 9.5 të Marrëveshjes, se Vendi është gati për operim.”

e) Duke fshirë nenin 4.1 të Marrëveshjes dhe duke shtuar nenin e mëposhtëm për zëvendësimin e tij:

“4.1 Kohëzgjatja (Kohëzgjatja) e kësaj Marrëveshjeje do të fillojë në Datën e Fillimit të Operacioneve dhe do të përfundojë në përvjetorin e pesëmbëdhjetë (15) të Konfirmimit të Instalimit ose të Afatit të Instalimit, cilido ndodh më herët, përveç kur Marrëveshja është rinovuar ose zgjatur me marrëveshje të ndërsjellë me shkrim midis Palëve.”

f) Duke shtuar një nen të ri 4.5 në Marrëveshje, si më poshtë:

“4.5 S2 do të ndërpresë sigurimin e Shërbimeve të Caktuara në lidhje me një vend, në datën e cila korrespondon me përvjetorin e pesëmbëdhjetë (15)



të Datës së Fillimit të Funkzionimit të Vendit për atë Vend (Data e Përfundimit të Funkzionimit të Vendit), pavarësisht nga dispozitat e nenit 4.1 dhe nga mospërfundimi i Kohëzgjatjes në këtë datë. Për të shmangur çdo dyshim, Autoriteti do të jetë përgjegjës vetëm për pagesën e tarifës së Shërbimit të Vendit, të përlogaritur sipas nenin 10 deri në datën e Përfundimit të Funkzionimit të Vendit dhe Autoriteti do të ndërpresë pagesën e Tarifës së Shërbimit të Vendit, kur të gjitha Tarifat e llogaritura të Shërbimit të Vendit të jenë paguar plotësisht. Asnjë Tarifë e Shërbimit të Vendit nuk do të llogaritet për një Vend pas Datës së Përfundimit të Funkzionimit të Vendit në lidhje me atë Vend.”

e) Duke fshirë nenin 10 të Marrëveshjes dhe duke e zëvendësuar atë me nenin si më poshtë:

“10. PAGESA

10.1 Autoriteti do t'i paguajë S2 një tarifë për Shërbimet e Caktuara për çdo Vend (Tarifa e Shërbimit të Vendit) në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

10.1.1 Tarifa e Shërbimit të Vendit do të llogaritet dhe do të paguhet në këste mujore të njëjta, secila në vlerën e $1/12$ të Tarifës Vjetore të

Vendit. Tarifa e Shërbimit të Vendit do të jetë pa TVSH.

10.1.2. Tarifa e Vjetore e Vendit për secilin Vend gjatë 12 muajve të parë, duke filluar nga Data e Fillimit të Vendit për atë Vend, do të jetë 2,260,000 euro (dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë mijë euro) (rezultati i pjesëtimit të 11.3 milionë eurove me 5 vendet).

10.1.3 Në çdo përvjetor 12-mujor të Datës së Fillimit të Vendit për secilin vend, vlera e Tarifës Vjetore të Vendit për atë Vend do të rritet me koeficientin 1.03, në mënyrë që Tarifa Vjetore e Vendit për atë vend të bëhet 2,327,800 (dy milionë e treqind e njëzet e shtatë mijë e tetëqind euro) në vitin e dytë pas Datës së Fillimit të Funkzionimit të Vendit për atë Vend, 2,397,634 euro (dy milionë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër euro) në vitin e tretë mbas datës së Fillimit të Funkzionimit të Vendit për atë Vend, dhe kështu me radhë deri në datën e Përfundimit të funksionimit të Vendit për atë Vend.

10.1.4 Pagesa e parë e Tarifës së Shërbimit të Vendit për çdo Vend duhet të paguhet ditën e parë kalendarike të muajit që bie menjëherë pas muajit kalendarik të Datës së Fillimit të Funkzionimit të

Vendit për atë Vend. Për çdo pagesë vijuese S2 do të lëshojë faturë në ditën e 20-të kalendarike të çdo muaji dhe Tarifa e Shërbimit të Vendit duhet të paguhet në ditën e parë kalendarike të çdo muaji pasardhës të datës së faturës.

10.2 S2 do t'i paguajë Autoritetit një tarifë mujore koncesioni të llogaritur në 2% të Tarifës së Shërbimit të Vendit, të pagueshme sipas nenit 10.1.1, pa TVSH. Kjo tarifë koncesionare do të mbahet nga Tarifa e Shërbimit të Vendit që i paguhet S2 nga Autoriteti.

10.3 Me qëllim shmangien e çdo dyshimi, vlera e Tarifës së Shërbimit të Vendit, e cila paguhet te S2 nuk varet nga sasia e Shërbimeve të Përcaktuara të ofruara realisht nga ana e S2 tek Autoriteti gjatë vitit, në zbatim të kësaj Marrëveshjeje.

10.4 Në rast se Autoriteti nuk kryen pagesat në datën përkatëse të përcaktuar më lart, S2 do të faturojë një tarifë financuese prej 1.5% për muajin në vonesë, proporcionale për muaj të pjesshëm mbi bazën e një muaji 30-ditor.

g) Duke fshirë nenin 12.1.4.

h) Duke amenduar nënparagrafin “a” të nenit 18.2.3 të Marrëveshjes, në mënyrë që fjalët “produkti i mesatares së pagesave totale mujore të paguara nga Autoriteti te RAPISCAN në vitin kalendarik që i paraprin datës së zgjidhjes” do të fshihet dhe do të zëvendësohet nga fjalët si më poshtë:

“produkti i mesatares së pagesave totale mujore të pagueshme nga Autoriteti te S2 gjatë vitit që i paraprin datës së zgjidhjes”.

6. VAZHDIMËSIA

6.1 Dispozitat e Marrëveshjes, përveç ndryshimeve të bëra me këtë Marrëveshje Amendimi, do të vazhdojnë të jenë në fuqi dhe efekt të plotë dhe do të përbëjnë një dokument me këtë Marrëveshje Amendimi.

6.2 Duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi të Marrëveshjes së Amendimit, referencat në Marrëveshje në lidhje me “Marrëveshjen” apo “Kontratën” do të lexohen dhe interpretohen si referenca për Marrëveshjen e Amenduar nga kjo Marrëveshje Amendimi.

6.3 Në rastet kur dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Amendimi janë në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjes, kjo Marrëveshje Amendimi do të ketë prioritet dhe përparësi, dhe dispozitat përkatëse të Marrëveshjes do të interpretohen në kontekstin e kësaj Marrëveshjeje Amendimi.



7. MARRËVESHJA E PLOTË

7.1 Kjo Marrëveshje Amendimi zëvendëson të gjitha marrëveshjet e tjera, qoftë me shkrim apo me gojë, midis palëve (përveç Marrëveshjes dhe Marrëveshjes për Zgjidhjen me Mirëkuptim të Mosmarrëveshjeve, të datës 28 prill 2015) dhe përmban të gjitha pranimet dhe marrëveshjet midis Palëve në lidhje me çështjet e trajtuara në të. Nuk është bërë asnjë përfaqësim, nxitje, premtim apo marrëveshje, verbale apo në çfarëdo mënyre tjetër, nga Palët, që nuk është përfshirë këtu dhe asnjë marrëveshje, deklaratë apo premtim të cilët nuk janë të përfshirë në këtë Marrëveshje Amendimi (përveç Marrëveshjes) nuk do të jetë e vlefshme apo detyruese.

8. DEKLARIMET DHE GARANCITË

8.1 Deklarimet dhe Garancitë e Autoritetit. Autoriteti jep deklarimet dhe garancitë e mëposhtme në lidhje me Marrëveshjen e Amendimit:

a) Tagrat. Autoriteti ka tagrat e kërkuara për të lidhur këtë Marrëveshje Amendimi. Të gjitha veprimet ligjore të nevojshme që duhet të ndërmerren nga Autoriteti për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje Amendimi janë ndërmarrë në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme. Në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje Amendimi, kjo Marrëveshje Amendimi do të bëhet një detyrim i vlefshëm, detyrues dhe i zbatueshëm për Autoritetin.

b) Mungesa e Konfliktit. Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje Amendimi nga Autoriteti nuk do të përbëjë shkelje të ndonjë kushti ose dispozite ose nuk do të përbëjë mospërmbushje të ndonjë marrëveshjeje të detyrueshme të lidhur nga Autoriteti, si dhe këto veprime nuk do të përbëjnë shkelje të ndonjë detyrimi, ligji, urdhërese, rregulloreje, urdhri ose dekreti të zbatueshëm për Autoritetin.

8.2 Deklarimet dhe garancitë e RAPISCAN dhe S2. RAPISCAN dhe S2 japin deklarimet dhe garancitë e mëposhtme, të cilat lidhen vetëm me to:

a) Tagrat. RAPISCAN dhe S2 kanë tagrat e kërkuara për të lidhur këtë Marrëveshje Amendimi. Të gjitha veprimet e nevojshme brenda shoqërive, si dhe veprimet e tjera që duhet të ndërmerreshin nga RAPISCAN dhe S2 për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e kësaj Marrëveshjeje Amendimi janë marrë në mënyrë të

rregullt dhe të vlefshme. Në Datën e Hyrjes në Fuqi të kësaj Marrëveshjeje Amendimi kjo Marrëveshje Amendimi do të bëhet një detyrim i vlefshëm, detyrues dhe i zbatueshëm për RAPISCAN dhe S2.

b) Mungesa e Konflikteve. Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje Amendimi nga RAPISCAN dhe S2 nuk do të përbëjnë shkelje të ndonjë kushti apo dispozite ose nuk do të përbëjnë mospërmbushje të ndonjë marrëveshjeje të detyrueshme të lidhur nga RAPISCAN dhe/ose S2, si dhe këto veprime nuk do të përbëjnë shkelje të ndonjë detyrimi, ligji, urdhërese, rregulloreje, urdhri ose dekreti të zbatueshëm për RAPISCAN dhe S2.

9. TË NDRYSHME

9.1 Efekti detyrues. Të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Amendimi do të jenë në interes dhe të detyrueshme për Palët dhe për pasardhësit e tyre në pikëpamje të interesave, për marrësit e të drejtave, administratorët dhe pasardhësit.

9.2 Gjuha e dyfishtë. Kjo Marrëveshje Amendimi është negociuar dhe hartuar në gjuhën shqipe dhe angleze, dhe të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Amendimi do të hartohen dhe interpretohen në të dyja gjuhët: anglisht dhe shqip. Megjithatë, në rast të konfliktit apo mospërputhjes midis versioneve të gjuhëve, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

9.3 Pavlefshmëria e pjeshme. Çdo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje Amendimi që konstatohet si e pavlefshme ose e pazbatueshme nga një gjykatë ose juridiksion kompetent do të përshtatet dhe kufizohet deri në masën e kërkuar nga kjo dispozitë brenda kërkesave të ligjit dhe ky konstatim dhe përshtatje nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje Amendimi.

9.4 Mosveprimet. Në rast se ndonjë nga Palët zbulon ndonjë mosveprim material në dispozitat e kësaj Marrëveshjeje Amendimi, të cilin e çmon thelbësor për përmbushjen me sukses të kësaj Marrëveshjeje Amendimi, ajo duhet të informojë Palët e tjera me shkrim. Palët do të negociojnë menjëherë me mirëbesim në lidhje me këto çështje, me qëllim të kryerjes së rregullimeve të arsyeshme, siç mund të jetë e nevojshme për të përmbushur objektivat e kësaj Marrëveshjeje Amendimi.

9.5 Kopjet. Kjo Marrëveshje Amendimi mund të nënshkruhet në një ose më shumë kopje të



njëjta, të cilat do të konsiderohen i njëjti dokument i vetëm dhe do të bëhen të vlefshme kur një ose me shumë nga këto kopje të njëjta të jenë nënshkruar nga secila prej Palëve dhe t'u jenë dorëzuar Palëve të tjera.

9.6 Shpenzimet. Secila Palë do të paguajë kostot dhe shpenzimet e veta në lidhje me negociatat, përgatitjen dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Amendimi.

10. LIGJI I ZBATUESHËM DHE JURIDIKSIONI

10.1 Parashikimet mbi ligjin e zbatueshëm dhe juridiksionin e neneve 21.16 dhe 21.17 të Marrëveshjes do të zbatohen *mutatis mutandis* edhe për këtë Marrëveshje Amendimi.

11. KONFIDENCIALITETI

11.1 Parashikimet për Konfidencialitetin të nenit 14 të Marrëveshjes do të zbatohen *mutatis mutandis* edhe për këtë Marrëveshje Amendimi.

11.2 Gjithashtu, kushtet e kësaj Marrëveshjeje Amendimi do të mbeten konfidenciale para plotësimit të kushtit të përcaktuar në nenin 2.1/a më sipër, përveç rastit kur një Palë është e detyruar në bazë të një detyrimi ligjor për të bërë publik informacionin.

Në dëshmi sa më sipër, Palët kanë nënshkruar këtë Marrëveshje Amendimi në datën e caktuar më lartë:

AUTORITETI

Shkëlqim Cani

Ministër

RAPISCAN SYSTEMS, INC.

Jonathan Fleming

Zëvendës-president

S2 ALBANIA

Jonathan Fleming

President

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë